



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 731 Prot.

Tiranë, më datë 08.05.2023

VENDIM
Nr. 283, datë 08.05.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.05.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik për projektin *“Linja 110 kV Elbasan 1 - Cërrik”*, me shtrirje në Bashkinë Cërrik dhe Bashkinë Elbasan, me aplikues dhe zhvillues **“Operatori i Sistemit Transmetimit, OST”**;
2. Investitori të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licensuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikqyrë këtë subjekt;
3. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr.107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 145 - 147;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

